



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E KANDIDATËVE
TË LËNDËS “EDUKIM FIZIK DHE SPORTE”**

I. HYRJE

Programi orientues për testimin e kandidatëve të lëndës “Edukim fizik dhe sporte”, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit të edukimit fizik dhe të sporteve. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- Dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- Programe lëndore të edukimit fizik dhe sporteve.
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënien e lëndës së edukimit fizik dhe sporteve.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të edukimit fizik dhe sporte.

II. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të edukimit fizik dhe të sporteve është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së edukimit fizik dhe sporteve për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe për zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor;
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të edukimit fizik dhe sporteve është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së edukimit fizik dhe sporteve.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm programi është paraqitur sipas një formati të caktuar; Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet që priten të zotërojë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese në funksion të tyre.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”</p> <p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sporteve:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit; - njeh dhe zotëron platformën e edukimit fiziko- sportiv; - njeh dhe harton rezultatet e pritshme mbi të nxënësit e nxënësve, në varësi të programit ushtrimor të kësaj platforme; - njeh dhe zbaton kartelën individuale të nxënësit dhe pyetësoin familjar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr 343, datë 19.08.2013. - Udhëzimi nr. 16, datë 03.08.2016 “Për vitin shkollor 2016-2017 në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore- edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 5, datë 25.02.2013 “Për standardet e mësuesit”. - Udhëzimi nr. 26, datë 15.08.2015 “Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë”. - Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. - Karta e Performancës së shkollës. - Standardet e shkollës si qendër komunitare. - Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë”.

	- Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.
FUSHA: PROGRAME LËNDORE	
Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të edukimit fizik dhe sporte në shkollë”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sporteve:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me mjedisin e shkollës; - përdor me efikasitet mjetet e nevojshme, si dhe mjediset sportive për zbatimin e programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe zhvillimin e aftësive fizike të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin dhe zhvillimin fizik nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, ose linjash në përputhje me kompetencat e programit; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të edukimit fizik dhe sporteve); - lidh edukimin fizik me sportet e tjera; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave; 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza kurrikulare, 2014. - Programet aktuale lëndore të edukimit fizik dhe sporte për arsimin bazë, klasat 1-9. - Programet aktuale lëndore të edukimit fizik dhe sporte për arsimin e mesëm të lartë, klasat 10-12. - Programet aktuale lëndore të edukimit fizik dhe sporte për arsimin e orientuar. - Programet e reja të edukimit fizik dhe sporteve (2015-2016), të bazuara në kompetenca për klasat 1,2,3 dhe 6,7,8 dhe klasën e 10-të.

<ul style="list-style-type: none"> - siguron informacion që demonstroi lidhjen e edukimit fizik dhe sportive me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE TË METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE	
<p style="text-align: center;">Kompetenca I</p> <p>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e edukimit fizik dhe sportive”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sportive:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikoi nxënësit me aftësi të kufizuara (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar në sport); - planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nxënësit obezë; - demonstroi qëndrim pozitiv lëndës së edukimit fizik dhe sportive; - edukoi të nxënësit dëshirën për t'u marrë me sport; - motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Situatat e të nxënësit, IZHA, 2015. - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij. - Platforma e edukimit fiziko – sportiv.

<p align="center">Kompetenca II</p> <p>“Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e edukimit fizik dhe sportive”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sportive:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar; - përdor metoda e teknika që nxisin nxënësit të merren me sport; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin fizik e sportiv të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - përdor metoda sportive në mësimdhënien – nxënien e edukimit fizik; - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - shpjegon parimet e hartimit të një kontrolli fizik apo testi. 	<ul style="list-style-type: none"> - Situatat e të nxënit, IZHA, 2015. - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese me në qendër nxënësin, si dhe metodologjinë e mësimdhënies së edukimit fizik dhe sporte. - Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësimi, për përgatitjen e planit ditor të mësuesit, për organizimin e orës së mësimi. - Udhëzues për mësuesin e edukimit fizik.
<p align="center">Kompetenca III</p> <p>“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në edukim fizik dhe sporte”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sportive:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton materiale të lojërave sportive duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Word; 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë që ka në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie –nxënie.

<ul style="list-style-type: none"> - nxit nxënësit të bëjnë prezantime në edukim fizik dhe sporte duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare në lëndën e edukimit fizik dhe sporte apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga Website. 	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

<p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sporteve:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat, datë 30.11.2013 - Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

<p>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
--	--

<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sporteve:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
--	---

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së edukimit fizik dhe sporte”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i edukimit fizik dhe i sporteve:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e edukimit fizik dhe sporteve në klasat 1-9 dhe 10-12; - përshkruan mënyrën e formimit dhe zhvillimit të nxënësve në klasat 1-9 dhe në klasat 10-12; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe të shprehjeve; - përmirëson marrëdhëniet sociale dhe krijon kushte të jetës për të pasur një shëndet të shkëlqyer; - përdor situata të ndryshme në edukim fizik dhe sporte, për të zhvilluar natyrshëm konceptet dhe aftësitë e programeve të klasave 1-9 dhe të klasave 10-12; - mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave të edukimit fizik në lidhje shkencat e tjera. 	<ul style="list-style-type: none"> - Materiale të ndryshme burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.